



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:035112

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730234

P.nr.57/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale ndaj të pandehurit E... V... nga Gj..., për shkak të veprës penale lëndim lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.15/2024, të datës 26.01.2024, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar publik, më datë 16.05.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: **E... V...** nga i ati B... e ëma H..., e lindur B..., i lindur më në fsh. K... K.Gjilanit, me vendbanim në Gjilan rr. " ..." nr. ..., ka të kryer fakultetin, i martuar, babë i dy fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

Më datë 16.12.2023 rreth orës 21:30 min, në rr...., në Gjilan, në shtëpinë e tyre i pandeuri me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor, ka ushtruar dhunë në familje duke lënduar lehtë të dëmtuarën bashkëshorten e tij në atë mënyrë që i pandehuri i revoltuar fillimisht kishte hasur në mosmarrëveshje verbale me të dëmtuarën në veturë, derisa ishin duke shkuar në shtëpi rreth orës 15:00, në lidhje me përdorimin e alkoolit nga i pandehuri, pastaj, në mbrëmje derisa sa i pandehuri ishte duke konsumuar birra me djalin e tij fillojnë një debat, ku ndërhyjnë të dëmtuara dhe i thotë se pse po e ofendon djalin e tyre A...., dhe në atë moment i pandehuri i'a kap dorën të dëmtuarës dhe i'a lakon, e rrëzon në dyshe dhe me trupin e tij qëndron mbi të dhe e ofendon me fjalë, ku më pas e dëmtuara largohet disi nga aty dhe e njofton policinë, me cka i ka shkaktuar të dëmtuarës lëndime të lehta tupore, si ndrydhje të indeve të buta

në bërëllin e majtë, e cila është shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë të topitur, që sipas ekspertizës mjeko-ligjore si të tilla paraqesin dëmtim të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par.3.1 e lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43,46, 47, 48, 49, 69, 70 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

DENIM ME KUSHT

I. Të pandehurit E.V... caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë)ditësh dhe dënim me gjobë në shumë prej 150(njëqindë e pesëdhjetë euro), të cilin dënim nuk do ta mbaj nëse brenda 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale.

II. Obligohet i akuzuari që të paguajë paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe taksën për Kompensimin e Viktimave të kriminit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 06.12.2023, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.15/2024, kundër të akuzuarit ndaj të pandehurit E... V... nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 16.05.2024, prezent ishin prokurorja e shtetit, i pandehuri dhe e dëmtuara, në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës.Ndërsa e dëmtuara ka deklaruar se heq dorë nga ndjekja penale dhe kërkesa pasuroro juridike.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, konstatoj se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 242 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, prandaj ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë

që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë, ekziston fakti se i pandehuri ka kryer veprën penale lëndim lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin për shkak të veprës penale lëndim lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 69,70 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin, si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, i njejt i ka premtuar gjykatës se nuk do të konsumoj alkool,ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksën për kompensimin e viktimave të krimit sipas ligjit (LIGJI NR. 08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 57/2024, më datën 16.05.2024

Bashkëpunëtore profesionale,

Vlora Selmani-Rahimi

Gjyqtari,

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme.